



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr.18/2008;
Më 09.09.2008, në ora 14:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Et'hem Çeku, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Safete Hadergjonaj dhe Sala Berisha – Shala;

Munguan: Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari, Zef Morina, ndërsa më arsye mungoj Mufëra Şinik;

Përcjellës prezent: Ibush Luzha (Përgjegjës i Njesisë së Akreditimit), Lumnije Berisha nga Presidenca, Lejla Selimi nga OSCE-ja, Haxhi Gashi nga USAID dhe Blerina Uka nga NDI;

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit;

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar 22 korrik 2008;
3. Miratimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
4. Miratimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;
5. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar 22 korrik 2008;

Procesverbali nga mbledhja e datës 22 korrik 2008 u miratua pa vërejtje.

III. Miratimi në parim të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;

Kryetarja – kërkoj nga Komisioni që të vlerësohet në parim Projektligji në fjalë dhe nga Grupi Punues që të filloj punën e amendamentimit të tij.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxorri këtë:

Përfundim

- I. Miratohet në parim Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
- II. Autorizohet kryetarja e Komisionit që të bëjë raportimin në emër të Komisionit në seancën plenare;

IV. Miratimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;

Kryetarja - kërkoj nga kryetari i Grupit punues z.Shatri, që të paraqes amendamentet e nxjerra nga takimet që kanë realizuar.

Haki Shatri – paraqiti para Komisionit amendamentet që ka hartuar Grupi punues dhe njihërit kërkoj që të miratohen.

Pas paraqitjes së amendamenteve dhe debatit në Komision, unanimisht u nxorr ky:

Përfundim

- I. Miratohen amendamentet e Grupit punues për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Akreditim Nr. 02/L-43;
- II. Autorizohet stafi mbeshtetës për standartizimin juridiko-teknik të amendamenteve të miratuara në Komision dhe përgaditjen e Raportit për seancën plenare;

V. Të ndryshme;

Kryetarja – njoftoi anëtarët e Komisionit për një varg kërkesash që kanë ardh në adresë të Komisionit, të cilat i elaboroj si më poshtë :

1. Kërkesën e ZRRE-së, që ka të bëjë me ndryshimin e tri rregulloreve të ZRRE-së për të cilat kërkon mbështetje nga komisioni si janë: a) Akti për kyçje eri kyçje të konsumatorit

- në sektorin e energjisë; b) Akti për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe c) Akti për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë;
2. Kërkesën e Qeverisë për emërimin e anëtarve të Komisionit të konkurrencës;
 3. Kërkesa e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të energjisë;
 4. Ri-miratimi apo ri-shqyrtimi i Raportit të Projekt ligjit për ndryshim e plotësim të Ligjit për NVM-të;
 5. Kërkesa e Kryesisë së Kuvendit që të rishqyrtohen Ligjet e pa nënshkruara nga PSSP-ja siç janë: Ligji nr.02/L-135 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët; Ligji nr. 03/L-027 për taksën e akomodimit ne objektet hoteliere dhe turistike; dhe Ligji nr 02/L-97 për shpronësim;
 6. Caktimi i vizitës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët;

Pas debatit të gjerë në Komision duke vlerësuar së çështje të rendësisë të veçantë, u vendos që të organizohet një mbledhje e radhës më datë 16 shtator 2008, dhe këto pika të lartëcekura të përfshihen si pika qendrore të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani